

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6357
E mërkurë, 7 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Kontrolle të rrepta
dhe privatësi e plotë,
Specialja lejon vizitat e
familjarëve në Hagë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGRON LLUGALIU | FAQE 4-5

SHËNUAM REKORD TË RI, DOGANA GRUMBULLOI MBI 600 MILIONË



Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka thënë se falë angazhimit të tij dhe të punëtorëve, dogana ka shënuar rezultate të prekshme sa iu përket të hyrave dhe luftimit të kontrabandës. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Llugaliu ka bërë me dije se nga janari i këtij viti dogana ka grumbulluar mbi 600 milionë euro. Sipas tij, dogana ka shënuar rritje të të hyrave mbi 27 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Po ashtu, Llugaliu ka bërë me dije se gjatë këtij viti është rritur për 22 për qind vlera e mallrave në kundërvajtje

ANALISTËT: NUK PRITEN REZULTATE TË SHPEJTA NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur skepticizëm për suksesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në prag të raundit të ri mes palëve në Bruksel, ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se nuk mund të priten rezultate të

shpejta në këtë proces. Sipas tyre, rrethanat ndërkombëtare dhe deklarimet e palëve nuk japin shpresa për ndonjë përparim të shpejtë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë | FAQE 3



AKTUALE



JA PSE NAIT HASANI NUK LEJOI QË ALBIN KURTI TË LIROHET NATËN NGA BURGU I NISHIT | F. 11



WESLEY CLARK SOT VIZITON KOSOVËN | F. 3

NDËRRON JETË ISH-USHTARI I UÇK-SË DHE DREJTORI I "VERIU.INFO", BLERIM ZHABARI | F. 7

ANDIN HOTI EMËROHET KRYESUES I KOMISIONIT QEVERITAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR | F. 7

EKONOMI



KURTI PARALAJMËRON VENDIME TË RËNDËSISHME NË SEKTORIN E ENERGJISË | F. 9

KAPET NË DRAGASH KAMIONI QË BARTTE MALLRA TË KONTRABANDUARA | F. 9

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Fuqive bërthamore u bëhet thirrje për çarmatim

MADRID, 6 KORRIK - Gjashtëmbëdhjetë vende që janë pjesë e Nismës së Stokholmit për çarmatimin bërthamor u kanë bërë thirrje fuqive bërthamore të veprojnë në drejtim të eliminimit të armëve bërthamore. Përfaqësuesit e këtyre vendeve janë takuar në Madrid më 5 korrik. Ky ishte takimi i katërt me radhë qëkur është iniciuar kjo nismë më 2019. Përmes një deklarate, këto vende u kanë bërë thirrje nëntë fuqive bërthamore që t'i zbatojnë detyrimet në bazë të Traktatit për mospërhapjen e armëve bërthamore dhe të "marrin masa të rëndësishme për ta promovuar çarmatimin". "Përpjekjet për çarmatim bërthamor janë të nevojshme në mënyrë urgjente", ka thënë ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, raporton "DPA". Maasi u bëri jehonë deklaratave



të presidentit amerikan Joe Biden dhe atij rus, Vladimir Putin, se një përplasje bërthamore në të ardhmen duhet të parandalohet me çdo kusht. "Duhet të vendoset një bazë për marrëveshje të reja të kontrollit të armëve në mënyrë

që numri i arsenaleve bërthamore të ulet edhe më shumë", ka thënë Maas. Vendet që janë pjesë e Nismës së Stokholmit nuk kanë armë bërthamore. Përveç Gjermanisë, në grup përfshihen edhe Japonia, Kanadaja, Spanja,

Suedia dhe Argjentina. Nëntë shtetet e njohura ose që besohet të kenë armatime bërthamore janë: Shtetet e Bashkuara, Rusia, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Kina, India, Pakistani, Izraeli dhe Koreja e Veriut. Instituti Ndërkombëtar për

Kërkimin e Paqes në Stokholm (SIPRI) ka thënë, në një raport të muajit të kaluar, se këto vende mbajnë rreth 13 080 armë bërthamore.

Anëtarët e takimit të Nismës së Stokholmit kanë përsëritur njoftimin e bisedimeve të reja të kontrollit të armëve midis Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara. Shtetet e Bashkuara dhe Rusia në muajin shkurt zgjatën traktatin "New Start" (Fillimi i Ri) për pesë vjet dhe në samitin e tyre muajin e kaluar Bideni dhe Putini kanë rënë dakord të fillojnë bisedimet e "stabilitetit strategjik". Traktati hyri në fuqi për herë të parë më 2011. Traktati kufizon numrin e kokave strategjike bërthamore. Bideni dhe Putini kanë thënë se zgjatja e traktatit mund të sigurojë një bazë për bisedimet e ardhshme për çarmatimin. Rusia ka thënë që ato diskutime mund të fillojnë këtë muaj.

Slovenia synon të nxisë zgjerimin e BE-së në Ballkan

STRASBURG, 6 KORRIK (ER) - Kryeministri i Sllovenisë, Janez Jansha, është zotuar të martën se do t'i shtyjë përpara përpjekjet për përshtetimin e procesit të integritetit për vendet e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE). Më 1 korrik Sllovenia ka marrë udhëheqjen gjashtëmujore të BE-së. Që nga viti 2019 procesi i integritetit ka ngecur, pasi disa vende anëtare, të prira nga Franca, bllokuan nisjen e negociatave për anëtarësim të Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërisë. Së fundi, Bullgaria është bërë pengesa kryesore për çdo përparim, pasi ajo ka

refuzuar ta japë dritën jeshile për Maqedoninë e Veriut për t'i filluar negociatat për shkak të disa mosmarrëveshjeve për identitetin dhe historinë. Brukseli është i shqetësuar për rritjen e ndikimit rus dhe kinez në vendet të cilave dikur iu kishte premtuar se kanë një rrugë të qartë drejt integritetit evropian. Jansha është duke planifikuar të organizojë një samit në muajin tetor midis udhëheqësve të 27 vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor si një përpjekje për t'i fuqizuar raportet. "Nëse nuk jemi të aftë ta realizojmë këtë, nëse nuk bëjmë një hap përpara në Ballkanin

Perëndimor, atëherë këto veprime do të ndërmerren nga dikush tjetër, nga dikush që ka interesa dhe vlera të ndryshme", ka thënë Jansha në Parlamentin Evropian në Strasburg. Ndërsa shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e ka mirëpritur deklaratën e Janshës, duke thënë se samiti i tetorit do të "dërgojë një mesazh të rëndësishëm se këto vende janë partnere thelbësore strategjike". Rusia dhe Kina kanë rritur përpjekjet e tyre për të ndikuar në vendet e Ballkanit gjatë pandemisë duke dërguar miliona vaksina të koronavirusit në rajon.



Arrestohet kryetari i Bashkisë së Lushnjës

LUSHNJË, 6 KORRIK - Kryetari i Bashkisë së Lushnjës, Fatos Tushe, është arrestuar nga Policia e Shqipërisë, pasi është duke u akuzuar për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Bëhet me dije se Tushe është arrestuar gjatë një operacioni të ndërmarrë me urdhër të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Përveç tij, janë arrestuar edhe 10 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të tjerë. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas arrestimit të Tushës, duke thënë se "Partia Socialiste u shërben zgjedhësve dhe jo të zgjedhurve". Përmes një



postimi në rrjetin social njëkohësisht kryetar i Partisë Socialiste, pjesë e së cilës është

edhe Tushe, ka thënë se "kryetari i Bashkisë së Lushnjës dhe cilido tjetër i akuzuar nga drejtësia në këtë rast apo në çdo rast, nuk do të ketë asnjë mbrojtje nga Partia Socialiste e duhet të përgjigjen vetë para drejtësisë, me avokatët e tyre e me gojën e tyre". "Çdo zgjedhës duhet ta dijë se besnikëria jonë ndaj tij nuk varet nga asnjë individ, po është flamur beteje i PS-së për ta bërë Shqipërinë të ardhmen tonë dhe çdo i zgjedhur nuk duhet ta harrojë se flamuri i PS-së mund të bëhet mbulesa e askujt, për asnjë interes apo faj vetjak", ka shkruar Rama. Edhe ambasadorja e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Juri Kim, përmes "Twitter"-it ka thënë se është koha që çdo person i përfshirë në korrupsion, sado i pushtetshëm të jetë, të ndëshkohet me burg. "Nëse je i përfshirë në korrupsion, sado i pushtetshëm mendon se je, tani është koha ta konsiderosh ndikimin e veprimeve të tua mbi familjen tënde dhe vendin tënd. Tani është koha të konsiderosh nëse vërtet ia vlen të shkosh në burg. Tani është koha të ndalosh. Askush nuk është mbi ligjin", ka shkruar ambasadorja Kim. Fatos Tushe drejton bashkinë e Lushnjës që tre mandate.

Integrimi i Ballkanit Perëndimor është në interesin e BE-së

Udhëheqësit e vendeve më të fuqishme të BE-së edhe një herë kanë ripërsëritur se e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është në BE. Pas një konference virtuale me shtetet e Ballkanit Perëndimor, kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se është në interesin e BE-së që ta integrojë Ballkanin. Edhe presidenti francez Emmanuel Macron ka shprehur mbështetjen e tij që gjashtë shtetet e këtij rajoni t'i bashkohen BE-së, ndërsa liderët e rajoni kanë kërkuar nga BE-ja që t'i mbajnë premtimet në raport me këto vende

“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka deklaruar se i sheh të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor si anëtare të ardhshme të Bashkimit Evropian (BE). Pas një konference virtuale me shtetet e Ballkanit Perëndimor, ajo ka thënë se kjo duhet të ndodhë për arsye gjeostrategjike. “Është në interesin e vet BE-së që të avancojë përpara këtë proces”, ka deklaruar Merkel për gazetaret, duke lënë të kuptohet në ndikimin e Rusisë dhe Kinës në rajon, por nuk përmendi me

emër asnjërin prej këtyre dy shteteve.

Kancelarja Merkel ka vlerësuar se bashkëpunimi rajonal, i promovuar që prej vitit 2014, në kuadër të procesit të Berlinit, tashmë ka arritur sukseset e para, siç është marrëveshja e roamingut që ka hyrë në fuqi më 1 korrik.

Në takimin virtual që kanë marrë pjesë kryeministri e Kosovës, i Shqipërisë, i Maqedonisë së Veriut, i Malit të Zi, i Bosnjë e Hercegovinës dhe i Serbisë si dhe liderët të BE-së, Merkeli ka vlerësuar se rajoni ka avancuar në rrugën e integrimit në BE. “Ne kemi hapur një numër të madh

kapitujsh, kemi rindërtuar procesin e zgjerimit. Për shumë vende të Ballkanit Perëndimor shpejtësia është shumë e ngadalshme, por edhe Bashkimi Evropian ka pasur shumë rezerva”, ka deklaruar kancelarja gjermane.

Ajo ka deklaruar se këto vende kanë bërë shumë, por që ka edhe shumë për t'u bërë në drejtim të korrupsionit. “Kur shoh se si po emërohen gjyqtarët e rinj, për shembull, me procesin e vettingut në Shqipëri, atëherë shoh se po bëhen përparime pararendëse të qëndrueshme”, ka deklaruar Merkel.

Tre milionë doza të vaksinës për Ballkanin Perëndimor

Kancelarja Merkel ka bërë me dije se Gjermania do të ndajë tre milionë doza të vaksinave për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ajo ka deklaruar se këto vakcina do të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Ajo, po ashtu, ka theksuar se ekzistojnë një sërë problemesh në mes të Kosovës dhe Serbisë, por se një

bashkëpunim mes shteteve të Ballkanit është i nevojshëm për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Bashkëpunimi për një treg të përbashkët rajonal dhe njohja e diplomave, ka shtuar Merkel, është diçka që nuk është arritur ende por, siç ka thënë, pritet që shpejt të ndodhë një gjë e tillë.


Në videokonferencë, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka deklaruar se “qartazi” ka shprehur mbështetjen e tij që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor t'i bashkohen BE-së. Kurse presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ripërsëriti qëndrimin se e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të jetë në Bashkimin Evropian dhe ka bërë thirrje që procesi i zgjerimit të bllokut evropian të përshejtohet.

“Prioriteti ynë i parë është që ta përshejtojmë agjendën tonë të zgjerimit në gjithë rajonin dhe t'u ndihmojmë partnerëve tanë në Ballkanin Perëndimor për t'i zbatuar reformat e nevojshme për avancim në rrugëtimin evropian”, ka thënë von der Leyen gjatë takimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, takim ky në kuadër të

Procesit të Berlinit.

Në adresimin e tij, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se Bashkimi Evropian duhet të bëjë pjesën e saj duke mbajtur premtimet e dhëna, ndërkaq Kosova duhet t'i bëjë detyrat e saj sa i përket përbushjes së reformave. Ai ka deklaruar se procesi i Berlinit u krijua në sfondin e sfidave gjeopolitike dhe pasigurive në rajon edhe në kohën kur anëtarësimi i rajonit të Ballkanit Perëndimor duhej i largët. Por, sipas Kurtit, as pas shtatë vjetësh, situata nuk ka ndryshuar shumë. “Kjo shtron nevojën për veprime të guximshme si nga BE-ja ashtu edhe nga Ballkani Perëndimor për ta ripërtërirë përkushtimin dhe për t'i forcuar lidhjet të cilat do t'i përshejtonin reformat”, ka deklaruar Kurti.

Procesi i Berlinit, një iniciativë diplomatike e kancelares gjermane Angela Merkel, filloi në vitin 2014, me qëllim për të mbështetur një të ardhme paqësore, të qëndrueshme dhe demokratike të Ballkanit Perëndimor, si dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian të rajonit.



Wesley Clark sot viziton Kosovën

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Ish-komandanti suprem i forcave të NATO-s, gjenerali Wesley Clark, sot (e mërkurë) do të qëndrojë për vizitë në Kosovë, ku fillimisht do ta vizitojë FSK-në. Ministria e Mbrojtjes ka bërë me dije se ceremonia e pritjes së tij do të mbahet me

fillim nga 10:00 në ambientet e kësaj ministrie. Sipas njoftimit, gjeneral Clarku do të pritë me nderime të larta ushtarake nga Njësia Ceremoniale e FSK-së. “Ceremonia e pritjes do të mbahet më 7 korrik 2021, ditë e mërkurë, duke filluar në orën 10:00, në ambientet e

Ministrisë së Mbrojtjes. Gjeneral Clarku do të pritë me nderime të larta ushtarake nga Njësia Ceremoniale e FSK-së. Pas takimit, ministri Amend Mehaj dhe gjeneral Clarku do të kenë adresime për media”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.





FAKTORË TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM MUND TË NDIKOJNË NË DINAMIKËN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

Analistët: Nuk priten rezultate të shpejta në dialogun Kosovë - Serbi

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur skepticizëm për suksesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në prag të raundit të ri mes palëve në Bruksel, ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se nuk mund të priten rezultate të shpejta në këtë proces. Sipas tyre, rrethanat ndërkombëtare dhe deklaratimet e palëve nuk japin shpresë për ndonjë përparim të shpejtë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Njohësit e rrethanave politike në vend nuk besojnë se vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi në Bruksel do të mund të sjellë rezultate të shpejta. Ata kanë deklaruar për "Epokën e re" se rrethanat ndërkombëtare dhe deklaratimet e palëve nuk japin shpresë për ndonjë përparim të shpejtë në këtë proces. Madje, sipas tyre, as BE-ja nuk do të bëjë ndonjë presion të madh ndaj palëve për të arritur këtë marrëveshjen përfundimtare.

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se Serbia nuk është e gatshme ta pranojë pavarësinë e Kosovës. "Deklaratimet e derisotme të

palëve nuk japin shpresë për ndonjë përparim të shpejtë dhe substancial. Unë jam ende skeptik për mundësinë e arritjes së marrëveshjes finale në formën e njohjes së ndërsjellë. Serbia nuk është e gatshme ta pranojë pavarësinë e Kosovës, por në këtë fazë ndoshta do të pajtohej që si kompensim për jetësimin e asociacionit të komunave serbe (në kuadrin e kornizave të Kushtetutës së Kosovës), të pranojë heshtazi realitetin e Republikës së Kosovës, nëse BE-ja do t'i binte pesë anëtarët që nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë këtë, dhe kështu do të hapej edhe për Kosovën rruga për integrimin në strukturat euroatlantike dhe, njëkohësisht, që Kosova edhe pa njohjen formale të Serbisë,

të jetë e barabartë në krijimin e tregut të përbashkët të Ballkanit Perëndimor, që kryeministri Kurti tashmë e ka pranuar si një mundësi zhvillimore", ka thënë Maliqi, duke treguar se si të silltet Kosova në këtë proces. "Modalitetet e kompromiseve që avancojnë pozitën e Kosovës mund të jenë të shumta. Ata duhet të negociohen, por nëse Kosova do të jetë konstruktive në dialog, pesha më e madhe e kompromiseve do të duhej t'i binte Serbisë si në Rambuje, ose në negociatën të Vjenës, dhe jo që Kosova të jetë bllokuese e procesit, sepse status kuoja aktuale i shkon në favor Serbisë, dhe jo Kosovës", ka thënë Maliqi.

As politologu Belul Beqaj nuk pret ndonjë rezultat të shpejtë

në këtë drejtim. "Jo, nuk pres, por më duket se nuk është e racionalë të mbetemi në defansivë diplomatike për shkak të ambicieve joreale. Nuk mund të diskutojmë për statusin e marrëdhënieve pa e njohur Serbia statusin e shtetit të pavarur të Kosovës, apo jo?!", është shprehur ai.

Beqaj ka vlerësuar se veprimet e deritanishme janë hap prapa zgjidhjes së dialogut me Serbinë. "Në fakt, deklaratimet publike të deritanishme vetëm sa po e ushqejnë politikën serbe që po e përdor dialogun për konsum të brendshëm në Serbi dhe për ta vazhduar mbështetjen ndërkombëtare regjimi i Aleksandër Vuçiqit! Pra, mungon qasja realiste që do ta implementonte marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe si obligim i trashëguar, duke i përfillur vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, ngaqë alternativat janë më të këqija: status quo-ja, rikthim në këmbime territoriale dhe kthim të strukturave paralele që nënkupton konfliktin

potencial", ka thënë Beqaj. Kurse kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka përmendur faktorët që do të ndikojnë në dinamikën e këtij procesi. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se në dinamikën e procesit do të ndikojnë faktorët të brendshëm dhe të jashtëm. "Nuk pres një marrëveshje të shpejtë dhe kjo është ajo hapësira që qeveria Kurti e ka të manovrojë edhe për një kohë. Do të mbahet edhe një takim në korrik të këtij viti, i cili do të jetë pak a shumë i ngjashëm me këtë që pamë, ndonëse palët mund të vendosin aty një kornizë të gjerë të asaj se çfarë do të bisedohet, pastaj institucionet evropiane shkojnë në pushim të verës. Në shtator janë zgjedhjet gjermane dhe largimi i kancelares Merkel nga politika gjermane, në tetor janë zgjedhjet lokale në Kosovë, në pranverë zgjedhjet serbe dhe më pas janë zgjedhjet presidenciale franceze", ka thënë Murati. Sipas tij, këtë proces mund ta përshpejtojë vetëm përfshirja e

Lajçaku: Gjithçka në dialog është politike

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë se nuk ka asgjë teknike në bisedimet për normalizim të raporteve. Në fillim të një takimi me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi, i ngarkuar për çështjen e dialogut, diplomati evropian ka vlerësuar çdo gjë është që diskutohet në mes të Kosovës dhe Serbisë është politike. “E mirëprita Besnik Bislimin, zëvendëskryeministrin e parë të Kosovës për diskutime sot para takimit të dialogut në nivelin e kryenegociatorëve nesër. Gjithçka në bisedimet mbi normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është politike. Asgjë s’është teknike”, ka shkruar Lajçak në llogarinë e vet në “Twitter”. Pas takimit me delegacionin e Kosovës, Lajçak do të takohet me delegacionin e Serbisë, i cili



udhëhiqet nga drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, më pas do të zhvillohet takimi i të dyja ekipeve, me ndërmjetësimin e BE-së. Në të kaluarën bisedimet Kosovë - Serbi janë zhvilluar në dy

nivele, mes delegacioneve në nivel teknik që kanë diskutuar ose aranzhuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në nivel politik mes kryeministrave ose presidentëve. Marrëveshjet janë arritur edhe në kuadër të dialogut teknik.

drejtpërdrejtë e amerikanëve në proces. “Të gjitha këto do ta ngadalësojnë dinamikën dhe ritmin e procesit të dialogut dhe nuk pres ndonjë rezultat apo dhe presion të madh sidomos nga BE-ja në këtë periudhë. Të vetmit që mund ta prishin këtë rehati janë amerikanët nëse vendosin që të përfshihen më drejtpërdrejt në bisedime”, ka

thënë Murati. Në marrëveshje të shpejtë mes palëve nuk beson as nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj. “Gjithçka është e mundur, por është pak e besueshme se mund të ketë marrëveshje të shpejtë. Dialogu kurrë nuk ka qenë ekskluzivitet i një qeverie. Ajo është temë më e madhe dhe e ka

të domosdoshme një platformë nacionale e të harmonizuar me gjithë spektrin”, ka thënë Nitaj për gazetën. Ai ka kritikuar qasjen e qeverisë ndaj këtij procesi, duke thënë se ajo ka qenë joserioze. “Qasja e kësaj qeverie ndaj dialogut ka qenë krejtësisht në shpërputhje me seriozitetin e materies. Qëndrimi se dialogu nuk është

prioritet, se dialogu është një proces i ri, mosinsistimi që në këtë proces të përfshihen ShBA-ja, kërkesa qesharake për shndërrimin e CEFTA-s në SEFTA, ose ‘zbulimi epokal’ se Kosova qenka për asociacion gjeografik, për vlerësimin tim, kanë qenë joserioze”, është shprehur ai. Raundi i fundit i dialogut është

mbajtur më 15 qershor të këtij viti. Ky ka qenë takimi i parë që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në kuadër të dialogut. Pas takimit të parë, zyrtarët e BE-së kanë bërë me dije se takimi i radhës në mes të Kurtit dhe Vuçiqit do të mbahet në fund të muajit korrik.

KDI-ja, letër publike Kurtit: Ofroni transparencë mbi dialogun me Serbinë

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti të ofrojë qartësi dhe transparencë mbi procesin e dialogut me Serbinë. Përmes një letër publike, KDI-ja ka vlerësuar se kryeministri as para dhe as pas vizitës në Bruksel nuk ka raportuar në Kuvend lidhur me pozicionin e Qeverisë së Kosovës për të ardhmen e këtij procesi. “Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ju drejtohet me këtë kërkesë publike për të ofruar transparencë rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Lëvizja Vetëvendosje në kohën kur ishte në opozitë në vazhdimësi ka insistuar që transparenca dhe llogaridhënia ndaj Kuvendit dhe qytetarëve rreth këtij procesi janë kyçe. Tani që

udhëhiqni qeverinë, nga ju presim që t’u përmbaheni këtyre parimeve. Më 15 qershor keni marrë pjesë në takimin e parë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian me Presidentin e Serbisë, ku keni paraqitur katër propozime. As para dhe as pas vizitës suaj në Bruksel nuk keni raportuar në Kuvend lidhur me pozicionin e Qeverisë së Kosovës për të ardhmen e këtij procesi si dhe më konkretisht lidhur me këtë takim”, është thënë në letrën e KDI-së. KDI-ja ka ftuar kryeministrin që sa më parë t’i drejtohet Kuvendit të Kosovës për të raportuar mbi takimet e mbajtura duke respektuar parimin e informimit të deputetëve, para dhe pas çdo takimi në kuadër të dialogut me Serbinë.

Kontrolle të rrepta dhe privatësi e plotë, Specialja lejon vizitat e familjarëve në Hagë



PRISHINË, 6 KORRIK (ER) - Nga 15 korriku të afërmit e ngushtë të akuzuarve mund t’i vizitojnë familjarët e tyre që janë duke u mbajtur në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Në Rregulloren e paraburgimit, në të afërm të ngushtë përfshihen: bashkëshortja / bashkëshorti, partnerja / partneri, prindërit, fëmijët, nipi / mbesa, vëllai, motra (ku përfshihen edhe vëllezër e motra vetëm prej nënës ose babait dhe vëllezër e motra të gjetura), gjyshërit, dhëndri dhe nusja. Sipas këtij përkufizimi, të gjithë të lartpërmendurit do të lejohen të ndajnë kohë me të afërmit e tyre në paraburgimin e Dhomave të Specializuara, madje pa u vëzhguar nga stafi i Sheveningenit, institucionit ndërkombëtar në të cilin po mbahen ish-krerët e UÇK-së. Kujdes të veçantë Specialja i ka kushtuar organizimit të vizitave prej familjes në bazë të një procedure të

thjeshtuar. Takimet personale ndërmjet të paraburgosurit dhe bashkëshortes / bashkëshortit dhe fëmijëve të të paraburgosurve realizohen në një vend të përshtatshëm brenda objektit të paraburgimit ku lejohet kontakt fizik. Ambianti është jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime për vizitat dhe komunikimet, përfshirë edhe kufizime kohore, duke u bazuar në planin ditor të punës të objektit të paraburgimit dhe disponueshmërinë e personelit. Orari i vizitave mund të ndryshojë në rast se të paraburgosurit apo vizitorit nuk i përshtatet, thuhet në këtë rregullore. Në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë janë duke u mbajtur: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Hysni Gucati, Naim Haradinaj, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.

10 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë paraqitur vetëm 10 raste të reja me Covid. Po ashtu, MSh-ja ka njoftuar se gjatë kësaj

periudhe kohore janë vaksinuar mbi 13 mijë e 300 qytetarë me vaksinën kundër Covidit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 13 397 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha

qytetet e Kosovës janë dhënë 219 885 doza të vaksinës. Deri me sot 52 975 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 2 143 testime, 10 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24

orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 16 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 397. Në total numri i rasteve aktive është 152", ka njoftuar MSh-ja.



Nagavci: Deri në shtator do të vaksinohen të gjithë mësimdhënësit në Kosovë



Prishtinë, 6 korrik (ER) - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Arsim në Kuvendin e Kosovës, ku ka shpalosur disa nga qëllimet që kanë krye të kësaj ministrie. Mes pesë qëllimeve kyçe të kësaj ministrie, ajo ka theksuar përmirësimin e pasojave të pandemisë dhe harmonizimin e mësimin me kërkesat e tregut të punës. "Qëllimet strategjike që i kemi prezantuar edhe në

programin tonë qeverisës, arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës e i digjitalizuar, sigurimi i cilësisë në mësimin parauniversitar dhe përmirësimi i pasojave të pandemisë. Qëllimi i dytë ka të bëjë me harmonizimin e mësimin me tregun e punës, ku kemi arritur përkrahjen e Zvicrës që do të merret me këtë. Menaxhimi efektiv i të gjithë mekanizmave të arsimit është synimi i tretë. Qëllimi i katërt ka të bëjë me cilësi të arsimit të lartë në harmoni me standardet ndërkombëtare, kurse

qëllimi i pestë përmirësimi i gjendjes së inovacionit shkencor", është shprehur ajo, duke bërë me dije se deri në shtator do të vaksinohen të gjithë mësimdhënësit në Kosovë. "Synimi ynë është që të vazhdojmë me prani fizike. Është një hap i mirë që ka filluar vaksinimi i mësimdhënësve dhe në shtator do të kemi të vaksinuar të gjithë mësimdhënësit. Besojmë se do të jetë me prani fizike në shkolla, por do të jemi të gatshëm edhe për forma të tjera", ka

deklaruar Nagavci. Më tutje, Nagavci ka njoftuar deputetët me disa nga punët që tashmë kanë nisur nga ministria që ajo drejton. Nagavci ka deklaruar se me synim të zbutjes së pasojave të pandemisë, kanë organizuar mësim shtesë për nxënësit. Po ashtu, Nagavci ka thënë se kanë ndarë 100 mijë euro si mbështetje për vazhdimin e mësimin të studentëve që janë pranuar për studime në universitet prestigjioze në botë. "Disa nga punët e përfunduara deri më tani

janë: vendimi për organizimin plotësues për ata nxënës që kanë pasur problem për mësimnxënie gjatë vitit 2020, kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Edukimit që studentët e nivelit master t'i zëvendësojnë mësimdhënëset shtatzëna që mos të ketë shpëputje të mësimin. Janë ndarë 100 mijë euro për studentët që janë pranuar për studime në universitet prestigjioze në botë si dhe është mbështetje financiare për vazhdimin e studimeve të tyre", ka thënë ajo.

Komisioni për legjislacion miraton Projektligjin për Gjykatën Komerciale

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Komisioni për Legjislacion Mandate, Imunitete ka miratuar të martën në parim Projektligjin për Gjykatën Komerciale. Nevoja për themelimin e kësaj gjykate është konsideruar e domosdoshme nga mazhoranca dhe një pjesë e opozitës, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shprehur mëdyshje për rolin e kësaj gjykate në sistemin juridik dhe

kushtetues të vendit. Kryetari i Komisionit për legjislacion, Adnan Rustemi, ka thënë se miratimi i këtij projektligji është i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Përkrahje ndaj këtij projektligji ka shprehur edhe Hajdar Beqa nga PDK-ja, por ka thënë se i njëjti është marrë i gatshëm nga ish-ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Ndërsa mëdyshje për miratimin e këtij projektligji ka

shprehur deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj. "Sot e kam problem ta paketoj në sistemin hierarkik institucional këtë gjykatë. Duhet më shumë informata për sistemin juridik dhe kushtetues për këtë gjykatë", ka deklaruar ai. Derisa e ka përkrahur miratimin në parim të këtij projektligji, Besnik Tahiri nga AAK-ja ka thënë se partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, me këto veprime po përkrah "politika të djathta".



Ndërron jetë ish-ushtari i UÇK-së dhe drejtori i "Veriu.info", Blerim Zhabari

VUSHTRRI, 6 KORRIK (ER) - Pas disa komplikimeve shëndetësore, ka ndërruar jetë në moshën 47-vjeçare drejtori i gazetës online "Veriu.info", Blerim Zhabari. Ky lajm ka tronditur komunitetin e gazetarëve dhe politikanët. Fillimisht, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) i ka shprehur ngushëllime familjes Zhabari, duke e vlerësuar lart kontributin e Blerimit në fushën e gazetarisë.

"Zhabari ndërroi jetë në orët e hershme të mëngjesit të sotëm pas disa komplikimeve shëndetësore. Ai ishte gazetar me përvojë 20-vjeçare dhe ndër vite ka punuar në medime të ndryshme të Kosovës. Zhabari ishte një prej dy bashkëthemeluesve të portalit 'Veriu.info', ku prej tre vjetësh ushtronte edhe detyrën e drejtorit. AGK-ja vlerëson lart kontributin dhe dedikimin që Zhabari pati ndaj profesionit të gazetarisë. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës u shpreh ngushëllime familjarëve, miqve dhe kolegëve të gazetarit Blerim Zhabari", është thënë në telegram ngushëllimin e AGK-së.

Familjes Zhabari i ka shprehur ngushëllime edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Lajm i hidhur për ndarjen nga jeta në moshë të re të luftëtarit të lirisë Blerim Zhabari. Ndajmë dhembjen me familjen, bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët. Do ta kujtojmë përgjithmonë kontributin e tij të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare. Blerimi u prehtë në paqe!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka ngushëlluar familjen Zhabari me rastin e ndarjes nga jeta të Blerimit. Në nderim të Blerimit, komuna e Vushtrrisë ka organizuar një mbledhje përkujtimore, ku më pastaj ai është varrosur në fshatin e tij të lindjes, Novolan të kësaj komune.



Ndërsa kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, i cili e ka pasur shok Blerim Zhabarin, e ka përshkruar si një trim gjatë luftës çlirimtare. "Mëngjesi sot zbardhi me një lajm të zi. Na la Blerim Zhabari - Dritoni i luftës na këputi shpirtin. Shok zemre, vëlla, bashkëluftëtar i orëve të para, atëherë kur ata nuk e kalonin numrin treshifror. Çdoherë i buzëqeshur e me humor. Përherë në vijën e parë të betejës për të mirën e përgjithshme. Bashkëshort, baba, djalë, vëlla e shok shembullor. Herët i përfshirë në LKÇK, militant i paepshëm i organizimit të luftës së armatosur. Pjesa që u shpëtuan arrestimeve të janar-shkurtit 1997, u takuam e jetuam bashkë

në Tiranë me dhimbjen për shokët, për fatet e organizimit dhe luftës, e me dëshpërimin e ngjarjeve të vitit 1997 në Shqipëri. Por, njëkohësisht, edhe optimist, se do të ringjallemi si feniksi, për ta çliruar Kosovën, për ta bërë 'zonjë të rëndë' Shqipërinë dhe për ta bashkuar kombin. Kryeoptimisti ishte ai, Blerimi ynë i dashur. Shkoi për një kohë të shkurtër në Zvicër, për t'u kthyer menjëherë me grupet e para të LKÇK-së në atdhe me fillimin e kryengritjes së armatosur pas epopesë së Jasharëve. Pas ardhjes në Kosovë, ishte pionier i organizimit të UÇK-së në rajonin e Artakollit në Qyqavicë", ka shkruar Murati në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se Blerimi ka qenë

çdoherë në krye të detyrës dhe përherë në vijën e parë të luftës çlirimtare. "I pandalshmi Dritoni i buzëqeshuri. Njeriu që krejt forcën dhe optimizmin e merrte te njerëzit, te populli ynë dhe që ato ia kthente prapë atij. Optimisti i pandreqshëm edhe në çastet më të rënda të luftës. Besimtari në rrugën e drejtë të luftës çlirimtare, militanti i LKÇK-së e luftëtar i shembull i UÇK-së. I tillë mbeti edhe pas luftës çlirimtare, kur shumëkush u shfityrua. Mbeti njeri, shok, familjar i dashur dhe në vazhdimësi kontributdhënës në të mirën e publike, atdheut e kombit. Aktivitetin politik e vazhdoi me LKÇK-në dhe LB-në, po ashtu ishte aktiv në jetën publike si gazetar dhe si aktivist i

mbrojtjes së ambientit. Tërë jetën në anën e të mirës e të drejtës. Do të na mungosh shumë, shok i paharruar", ka shkruar Murati. Blerim Zhabari ka lindur më 21 dhjetor të vitit 1974 në fshatin Novolan të Vushtrrisë. Shkollën fillore e ka përfunduar në Novolan, kurse të mesmen në gjimnazin "Muharrem Bekteshi" në Vushtri. Tani vonë ai ka përfunduar edhe Fakultetin e Ekologjisë. Prej 22 qershorit të vitit 1999 ka filluar punën në Komunën e Vushtrrisë në zyrën e informimit. Blerim Zhabari ishte një prej dy bashkëthemeluesve të "Veriu.info", ku prej tre vjetësh ushtronte edhe detyrën e drejtorit të portalit. Zhabari ka lënë pas vetes gruan dhe dy fëmijë.

Andin Hoti emërohet kryesues i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur



Prishtinë, 6 korrik (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, e ka emëruar Andin Hotin kryesues të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur. Zyra e kryeministrit ka njoftuar se emërimi i djalit të Ukshin Hotit në këtë pozitë, tejkalon çështjet politike. "Çështja e personave të zhdukur është një nga çështjet prioritare të Qeverisë së Kosovës dhe emërimi i sotëm tregon që kjo temë shkon përtej politikës.

Dhimbja dhe ankthi me të cilën familjet përballeshin që 23 vjet, rritet çdo ditë e më shumë, andaj është obligim ynë si qeveri që të bëjmë më të mirën e mundshme për t'ua zbutur këtë gjendje duke u angazhuar më shumë për zbardhjen e fatit të më të dashurve të tyre. Për Qeverinë e Kosovës është e rëndësishme që të kemi një front të përbashkuar karshi Serbisë në kërkesat tona për ballafaqim me të kaluarën", ka njoftuar Zyra e Kryeministrit.



FLET PËR "EPOKËN E RE", AGRON LLUGALIU

Shënuam rekord të ri, dogana grumbulloi mbi 600 milionë

Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka thënë se falë angazhimit të tij dhe të punëtorëve, dogana ka shënuar rezultate të prekshme sa iu përket të hyrave dhe luftimit të kontrabandës. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Llugaliu ka bërë me dije se nga janari i këtij viti dogana ka grumbulluar mbi 600 milionë euro. Sipas tij, dogana ka shënuar rritje të të hyrave mbi 27 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Po ashtu, Llugaliu ka bërë me dije se gjatë këtij viti është rritur për 22 për qind vlera e mallrave në kundërvajtje

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 KORRIK - Drejtor i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka thënë se dogana ka shënuar rekord sa iu përket të të hyrave. Ai në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se falë punës së tij dhe të kolegëve, Dogana e Kosova ka arritur të grumbullojë mbi 600 milionë euro. "Të hyrat e mbledhura tejkalojnë dukshëm vitin e kaluar dhe në përgjithësi vërejmë rritje të trendit të të hyrave. Në kohën që

flasim kemi tejkalar shumë prej 600 milionë eurosh, që është edhe një rekord i ri. Ndërsa sa i përket rritjes sipas vendeve, mund të themi se ndikimi i rritjes së përshkallëzimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë më vendet e BE-së ka ndikuar që të prijë me rritje Gjermania, si dhe ngjashëm është reflektuar një rritje e proporcionit për importet nga Turqia, pasi edhe këtu është thelluar përshkallëzimi vjetor i rënies së taksës së doganës", ka thënë Llugaliu.

Më tutje, ai ka thënë se si rezultat

i punës së doganës është arritur që të ndalet kontrabanda e mallrave. "Në përgjithësi kemi një rritje të konsideruar të zbulimeve të kontrabandës, që karakterizohet me mallrat strategjike për të hyrat, me theks të veçantë duhani dhe produktet e tij, ku rishtazi është raportuar edhe në media zbulimi dhe sekuestrimi i 2.2 milionë cigareve në Mitrovicën veriore, zbulimi dhe sekuestrimi i një kamioni të madh me duhan fletë në sasi prej 5 tonësh që është kapur në Mitrovicë. Kemi pasur mallra të tjera të sekuestruara në

sasi të theksuara, siç janë fishekzjarrët, aromat për nargjile dhe produkte të konsumit të gjerë", ka thënë Llugaliu.

Ndërsa sa i përket sasisë së mallrave të kontrabanduara, Llugaliu ka thënë se vlera e mallrave në kundërvajtje është rritur për 22 për qind. "Në përgjithësi mund të konstatojmë se vlera e mallrave në kundërvajtje është rritur me 22 për qind krahasuar me vitin paraprak falë rritjes së angazhimeve si dhe punës efektive në parandalimin e rasteve nga ana e doganës", është shprehur ai.

"Epoka e re": Z. Llugaliu, çfarë e ka karakterizuar punën tuaj prej se jeni në krye të Doganës së Kosovës?

Llugaliu: Dogana e Kosovës në vazhdimësi ka pasur zhvillime të rëndësishme për t'i përballuar kërkesat bashkëkohore për

arritjen e qëllimeve të saj. Megjithatë, shpesh janë bërë ndryshime dhe reforma që nuk kanë pasur vëmendjen e nevojshme në rezultatet e arritura. Përveç kësaj, disa procese të rëndësishme për ushtrimin e kontrollit të mallrat me rrezikshmëri të lartë nuk janë përcjellë me ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme të kontrollit. Edhe pse stafi i Doganës së Kosovës përbëhet nga zyrtarë profesionistë dhe të përkushtuar, në raste të caktuara Dogana e Kosovës me burimet e brendshme ka adresuar rastet e korrupsionit dhe dyshimeve për abuzim me detyrën. Me qëllim që këto sfida të trajtohen drejt, që nga ardhja ime në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, jemi fokusuar paralelisht për identifikimin e fushave kryesore të rrezikut për shmangie të taksave, për mbrojtjen e interesit

Kapet në Dragash kamioni që bartte mallra të kontrabanduara

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se në rrugën "Zhur" të Dragashit ka ndaluar një kamion me targa vendore, i cili dyshohej se kishte të

ngarkuara mallra, për të cilat nuk posedonte dokumente mbi prejardhjen dhe transportin. Sipas policisë, i dyshuari në kamion kishte pasur të

ngarkuara mallra të importuara nga jashtë si: televizorë, rrobalarëse, shporet elektrik, frigoriferë dhe një tepison, për të cilat nuk posedonte leje. Kamioni

së bashku me mallra është dërguar për vlerësim në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Rasti në fjalë është duke u hetuar nga organet kompetente.



dhe shëndetit publik si dhe janë ndërmarrë transferime dhe risistemime të një numri të konsideruar të stafit, duke filluar nga menaxhmenti i lartë. Si rezultat kemi nisjen e disa proceseve që kanë filluar të japin rezultate të pritshme në të gjitha këto fusha të cekura më lart. Në përgjithësi kemi një rritje të konsideruar të zbulimeve të kontrabandës, që karakterizohet me mallrat strategjike për të hyrat, me theks të veçantë duhani dhe produktet e tij, ku rishtazi është raportuar edhe në media zbulimi dhe sekuestrimi i 2.2 milionë cigareve në Mitrovicën veriore, zbulimi dhe sekuestrimi i një kamioni të madh me duhan fletë në sasi prej pesë tonësh që është kapur në Mitrovicë. Gjithashtu, kemi pasur mallra të tjera të sekuestruara në sasi të theksuara, siç janë fishekzjarrët, aromat për nargjile dhe produkte të konsumit të gjerë. Këto rezultate janë të dalluara nëse konsiderojmë të kaluarën dhe janë të mundshme vetëm përmes përkushtimit të stafit dhe bashkëpunimit me publikun dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Në çështjen e korrupsionit në një rast është finalizuar aktakuza në një rast hetimor të zhvilluar nga hetimet e doganës, me ç'rast dhjetë zyrtarë kanë përfunduar të akuzuar të cilat i janë nënshtruar suspendimit. Në një rast tjetër hetimi është zbuluar se një

zyrtar me dyshim të arsyeshëm besohet se ka lejuar kontrabandën e barërave në vendkalimin e këmbësorëve. Ky zyrtar është arrestuar së bashku me të dyshimtin që ka bërë kontrabandën dhe që të dy vijnë në një nën masën e arrestit, ndërsa një sasi e madhe e barërave është zbuluar në një garazh nëntokësor në Prishtinë. Duke konsideruar këto rezultate, si dhe performancën pozitive ekonomike në të cilën është duke vijuar shteti ynë, ne kemi parë një rritje të konsiderueshme të rezultetit në të hyra, e cila tejkalon thellësisht rezultatet në vitet e kaluara, përfshirë vitin 2019, që nuk është sfiduar nga efektet e pandemisë. Të gjitha këto veprime vlerësuese kanë për qëllim që të përgatitin organizatën për një reformë të konsiderueshme të proceseve, sistemit të punës dhe stafit në përgjithësi, me qëllim që të krijojmë një kulturë të orientimit në rezultate dhe shërbim ndaj publikut.

“Epoka e re”: Sa janë të hyrat e grumbulluara nga importi që nga janari i këtij viti dhe nga cilat shtete?

Llugaliu: Të hyrat e mbledhura tejkalojnë dukshëm vitin e kaluar dhe në përgjithësi vërejmë rritje të trendit të të hyrave. Në kohën që flasim kemi tejkaluar shumë prej 600 milionë eurosh që është edhe

“NIKE”, “ADIDAS” DHE “TOMY HILFINGER”, MARKAT MË TË FALSIFIKUARA NË KOSOVË

“Epoka e re”: Z. Llugaliu, çfarë markash të produkteve janë të konfiskuara më së shumti?

Llugaliu: Për periudhën janar-qershor të vitit 2021 Dogana e Kosovës ka konfiskuar mallrat me markat tregtare të falsifikuara si: 18 raste për “Nike”, me 4 236 copë, 14 raste “Adidas”, me sasi 2 131 copë, 7 raste “Tommy Hilfinger”, me sasi 2 130

copë, 5 raste “Hugo Boss”, me sasi 1 277, 4 raste “Chanel”, me sasi 5 740 copë, 3 raste “Calvin Klein”, me sasi 914 copë, 3 raste “Puma”, me sasi 119 copë, 3 raste “Levi’s”, me sasi 71 copë, 3 raste “Hobby”, me sasi 33 660 copë, dy raste “Apple”, me sasi 29 copë, dy raste “Prada”, me sasi 99 copë, si dhe dy raste “Gucci”, me sasi 1 625 copë etj.

një rekord i ri. Ndërsa sa i përket rritjes sipas vendeve, mund të themi se ndikimi i rritjes së përshkallëzimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e BE-së ka ndikuar që të prijë me rritje Gjermania, si dhe ngjashëm është reflektuar një rritje e proporcionit të ngjashëm për importet nga Turqia, pasi edhe këtu është thelluar përshkallëzimi vjetor i rënies së taksës së doganës.

“Epoka e re”: Po në raport me vitin e kaluar, çfarë bilanci kemi?

Llugaliu: Duke bërë krahasim mes të viteve 2020 - 2021, në aspektin e taksave vërehet rritje

në shumën prej 128.1 milionë eurosh ose shprehur në përqindje 27.06 për qind.

“Epoka e re”: Në cilat shtete është eksporti më i lartë dhe çfarë vlere monetare kap?

Llugaliu: Kosova ka raporte tregtare në aspektin e eksportit të mallrave me vende të ndryshme, por kohën e fundit po vërejmë një trend të rritjes së jashtëzakonshme të eksportit, ku prijnë vendet e BE-së dhe ShBA-ja. Dhe, krahasuar me vitin e kaluar, eksporti ynë ka shënuar rritje të vlerës prej 66-përqindësh. Konkretisht, viti 2020 ka qenë më i mirë sesa vitet

paraprake, ndërkaq që deri në këtë periudhë këtë vit është tejkaluar dukshëm viti 2020, për faktin se në vitin 2020 janë eksportuar mallra në vlerë prej 193.9 milionë eurosh, ndërsa tani në po të njëjtën periudhë kemi 322 milionë euro.

“Epoka e re”: Çfarë sasi të mallrave të konfiskuara kemi më së shumti dhe nga cili është vendi i origjinës së tyre?

Llugaliu: Rëndomë në kohët e mëhershme konfiskimet janë përshkruar nga produkte të ndryshme të konsumit të gjerë, ndërsa gjatë këtyre muajve karakteristike ka qenë konfiskimi i theksuar i produkteve akcizore, ku dominojnë produktet e duhanit për tymosje dhe një rast i konsiderueshëm me barëra. Në përgjithësi mund të konstatojmë se vlera e mallrave në kundërvajtje është rritur 22 për qind krahasuar me vitin paraprak falë rritjes së angazhimeve si dhe punës efektive për parandalimin e rasteve nga ana e doganës.

“Epoka e re”: Z. Llugaliu, sa është numri i automjeteve të reja dhe të përdorura që kanë hyrë në Kosovë nga janari e deri më tani?

Llugaliu: Pas vitit të kaluar, kur kishim rënie të importit të automjeteve gjatë këtij viti, kemi shënuar rritje të ndjeshme. Gjatë vitit 2020 numri i veturave të reja ishte 1 217 copë, derisa gjatë këtij viti është 1 642 copë.

Kurti paralajmëron vendime të rëndësishme në sektorin e energjisë

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Kryeministri Albin Kurti ka deklaruar të martën se Kosova duhet të ketë një strategji të energjisë të koordinuar mirë me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, e cila, sipas tij, do të rezultonte me rritjen e standardit të jetesës për të gjithë qytetarët e vendit.

Kurti në hapje të punëtorisë “Tranzicioni i drejtë energjetik në Kosovë”, të organizuar nga Ministria e Ekonomisë, ka thënë se me implementimin e strategjisë së energjisë pritet të krijohen vende të reja të punës dhe të krijohen hapësira për investime. “Si shtet e si vend jemi në vitin kur priten të merren vendime të rëndësishme në sektorin e energjisë, vendime të cilat do ta definojnë këtë sektor jo vetëm për 10 vjetet e ardhshëm, por edhe më tej se atë. Kosova është në fazën e rishikimit të strategjisë së energjisë, hartimit të planit për energji dhe klimë si dhe rishikimit të legjislacionit në fushën e energjisë. Të gjitha këto nisma do t'i definojnë synimet tona. Qëllimi ynë është që strategjia e energjisë të jetë mirë e informuar, e zbatueshme dhe me

objektiva të sakta dhe të matshme. Kosova nuk duhet të ketë një strategji vetëm që t'i përmbushë kriteret legjislative, mirëpo një strategji e koordinuar mirë me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, që rezulton me rritjen e standardeve të jetesës për të gjithë qytetarët e Kosovës. Meqë jemi në shërbim të qytetarëve, pritet që kjo strategji të krijojë vende të shumta pune, hapësirë për investime duke lehtësuar proceset, ta aktivizojë shoqërinë përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje si dhe të krijojë mundësi përfitimi për ta”, ka thënë Kurti.

Ndërsa ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se një tranzicion i drejtë dhe i mbështetur nga të gjithë aktorët është çelësi për ta bërë një tranzicion të përballeshëm për qeverinë, qytetarët dhe vetë ekonominë e Kosovës. Rizvanolli ka theksuar se sfidat e sektorit energjetik në Kosovë janë të shumta teksa ka numëruar disa prej tyre. “Investimet në këtë sektor jo vetëm që kërkojnë fonde e kohë, por duhet të jenë mirë të planifikuara. Një



tranzicion i drejtë dhe i mbështetur nga të gjithë aktorët është çelësi për ta bërë një tranzicion të përballeshëm për qeverinë, qytetarët dhe vetë ekonominë e Kosovës. Prandaj, për zhvillimin e një politike të qëndrueshme energjetike në vendin tonë është qenësore që t'i

identifikojmë skenarët e duhur për një tranzicion energjetik dhe analiza e tyre kritike duke u bazuar në përputhshmërinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji si dhe qëndrueshmërinë dhe përballeshmërinë financiare”, ka thënë Rizvanolli.

Punëtorja “Tranzicioni i drejtë energjetik në Kosovë” për sektorin e energjisë dhe koordinimin e donatorëve në Kosovë ka për qëllim informimin e vendimeve teknike dhe politike që do të merren gjatë procesit të finalizimit të strategjisë kombëtare të energjisë.

Komuna e Prishtinës nis aksionin për eliminimin e drurit 'Arra e Hindit'

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se në rrugën "Agim Ramadani" ka larguar drurin e njohur si "Arra e Hindit". Sipas kësaj komune, ky lloj druri është duke shkaktuar dëme në infrastrukturën e përgjithshme në kryeqytet. Komuna që drejtohet nga Shpend Ahmeti ka paralajmëruar se do ta vazhdojë aksionin për eliminimin e këtij lloji druri. "Komuna e Prishtinës trajtoi 'ishullin' në mes të rrugës 'Agim Ramadani', me ç'rast u bë

eliminimi i drurit të dëmshëm 'Arra e Hindit'. Sipas ekspertëve, 'Arra e Hindit' njihet si lloj i drurit që shkakton dëme në infrastrukturë rrugore, objekte dhe shtëpi, dëmtimin e kanalizimeve, tharjen e llojeve autoktone të drunjve, por edhe në shëndetin e njeriut duke liruuar materie toksike. Komuna e Prishtinës do ta vazhdojë aksionin për eliminimin e këtij lloji të drurit me qëllim të parandalimit të dëmeve që ky lloj i drurit shkakton", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Smajl Latifi rikandidon për kryetar të Rahovecit



RAHOVEC, 6 KORRIK (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka zyrtarizuar kandidaturën e Smajl Latifit për kryetar të Rahovecit, i cili aktualisht udhëheq këtë komunë. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se kryetari Smajl Latifi është model i një kryetari për punën e ndershme që ka bërë, për transparencën e vlerësuar nga të gjitha organizatat ndërkombëtare. "Vëllezërit dhe motrat tona në

diasporë janë njerëzit që e duan më së shumti Kosovën. Në kohët më të vështira e ndihmuan atdheun. Nuk janë ata njerëz që e ndihmojnë mashtrimin. Pra, diaspora jonë nuk do ta ndihmojë mashtrimin. Kanë menduar se e kanë lehtë pasi nuk jetojnë këtu, po nuk është lehtë me mashtrua diasporën", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se nuk është kundër ndryshimit. "Ndodhi ajo që më së shumti ia kam pasur frikën nga kjo

qeveri. Në vend se të bëjë ndryshimin, ne po e marrim mashtrimin nga ta. Kurrë s'kam pritur që në Kuvendin e Kosovës, për shkak të kryetarit tuaj, Smajl Latifi, me i mbrojtur subvencionet dhe mos me ua heq 400 euro. Mos të kishte ndodhur alarmi që e ka dhënë kryetari juaj, Smajl Latifi, ishte duke ndodhur sanksioni për fermerët, vreshtarët dhe të tjerëve, duke ua hequr ato subvencione", ka thënë Haradinaj.

Skenderaj bëhet me ndërmarrje të re publike

SKENDERAJ, 6 KORRIK (ER) - Pas një pune intensive nga grupi punues, kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pranuar çertifikatën e regjistrimit të ndërmarrjes publike lokale "Eko Natyra", ndërmarrje kjo e cila do të kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirave publike, shesheve, menaxhimin e mbeturinave, kultivimin dhe mbjelljen e drunjve dekorativë dhe luleve, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe objekteve publike në komunën tonë etj. Me këtë rast, kryetari Jashari është shprehur i lumtur që me themelimin e kësaj ndërmarrje publike lokale,

përveç përmirësimit të gjendjes së mjedisit, do të zvogëlohet edhe papunësia në Komunën e Skenderajt përmes punësimit të rinjve që do të punojnë në këtë ndërmarrje. "Për këtë sukses të arritur, bashkë me nënkryetarin Lushtaku falënderuam Komisionin Komunal të Aksionarëve me kryesues Gani Kerolli dhe anëtarët asambleistë, Naser Bajraktari e Dorarta Ndreshaj, për angazhimin dhe punën e bërë. Kështu, hap pas hapi, me projekte konkrete po arrijmë ta jetësojmë misionin tonë për zhvillimin e Skenderajt", ka thënë Jashari.



Mërgimtarët mund ta shfrytëzojnë parkingun e komunës së Suharekës

SUHAREKË, 6 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dijes se parkingun në oborrin e objektit të kësaj komune do të jetë i hapur

mërgimtarët të cilët kanë ardhur për pushime në vendlindje. Ai ka thënë se ka marrë një vendim të tillë në mënyrë që mërgimtarit të kryejnë shërbimet e tyre

komunale. "Po ashtu, edhe hapësira e 'Tregut Javor' u lejohet për parking, me përjashtim të ditës së tregut (e martë). Kjo mundësi u krijohet për qasje sa më të lehtë për

kryerjen e shërbimeve të tyre. Duke ju shprehur mirëseardhje, shpresojmë të kaloni pushime të mbara në atdheun tuaj! Ne jemi në shërbimin tuaj!", ka thënë Muharremaj.



RRËFIME NGA I BURGOSURI DHE I MBIJETUARI I MASAKRËS NË BURGUN E DUBRAVËS, NAIT HASANI

Ja pse Nait Hasani nuk lejoi që Albin Kurti të lirohet natën nga burgu i Nishit

Pas bisedës me bacën Adem diskutuam me Albinin për atë që na tha si dhe për gjendjen në Kosovë. Kujtonim ato që ai kishte kaluar në burgje. Kujtonim dhe tregonte Albini për bacën dhe angazhimin e tij si përfaqësues politik i UÇK-së në Prishtinë. Tregonte guximin e tij, gatishmërinë deri në flijim për Kosovë e atdhe dhe për kauzën shqiptare. Të gjitha këto për mua që isha në burg ishin një ngjarje interesante dhe vërtetë dinjitoze, ashtu siç kishim mësuar për bacën që ishte përfaqësues politik në kohë lufte, në qendër të Prishtinës, që bënte përfaqësimin e drejtë të luftës sonë për liri, para faktorit ndërkombëtar dhe policisë e ushtrisë serbe në kryeqytet. Albini tregonte për përfaqësimin dinjitoz të bacës Adem dhe mbrojtjen e kauzës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës para çdo kujt si qëllim final që kishte lirinë dhe çlirimin tonë kombëtar. Në këtë bashkëbisedim me Albinin për bacën Adem, ra zilja dhe erdhi koha të binim për të fjetur. Ramë për të fjetur dhe duke kujtuar ato që kisha folur në telefon me bacën Adem, që duhet me u përgatitë me lexime, me libra të ndryshme, sepse do i duhemi vendit dhe duhet ta ndërtojmë vendin tonë. Mu kujtua një rast me bacën Adem në gazetën e tij "Forumi" që e nxirrte në vitet e '90-ta. Aty merreshin me shkrime dhe shkruanin intelektualë të ndryshëm tanë, për tema të ndryshme të zgjidhjes së çështjes së Kosovës me koncepte të ndryshme nga ato që ishin në Kosovë që përfaqësohej nga lëvizjet demokratike. Por, në këtë kohë bëhej një gjykim politik në gjykatën e qarkut në Prishtinë, i grupit të Xhavit Hazirit, një nga drejtuesit politik dhe ish i burgosur politik me shokët e tij në këtë gjykatë. Unë kisha qëndruar me Xhavitin, Bajrushin, Hajredinin, Raif Qelën e të tjerë në këtë gjykatë që policia serbe i kishte vë në bankën e të akuzuarve për dënimin e këtij grupi. Mua më duhej të përcillja këtë gjykim dhe më duhej të hyja në gjykatë për ta përcjellë gjyqin. Si mundësi ishte baca Adem me gazetën e tij "Forumi". Unë duhej të merrja akreditimin e tij si gazetar dhe të hyja në gjyq për ta përcjellë gjykimin. Shkova në mbrëmje të shtëpia e bacës Adem dhe i thash: kam ardhur tek ti për të marrë një dokument që jam gazetar i gazetës "Forumi" për të përcjellë gjykimin. Është gjykim i rëndësishëm për

Lëvizjen që me u informuar se si kanë rrjedhë gjërat gjatë gjykimin. Baca Adem më dha akreditimin dhe unë u bëra gazetar. Të nesërmen kur fillojë gjykimin si gazetar i "Forumit" paraqitem të dera në gjykatë. Policët na kërkojnë dokumentet dhe unë pa hezitim ia tregoj akreditimin. Policët pasi e shikojnë dokumentin tim zyrtar më lejojnë të hyjë brenda më shumë gazetar të tjerë. Aty pas pak i sjellin të burgosurit, shokët e mi që kishim qenë bashkë më herët nëpër burgje. Kur me shohim Xhavit, Bajrushin, "Dini", Raifi, etj., mbesin pa "tekst", mendojnë që edhe unë jam arrestuar. Pasi fillon gjykimin unë i përcjelli me kujdes ato që u thoshin aty si dhe me një kujdes të veçantë për Lëvizjen Popullore. Aty shohë dy rryma politike nga dy grupe. Aty shoh Lëvizjen Popullore të Kosovës dhe LKÇK-në. Konceptin e Lëvizjes që me çdo çmim, por dhe me luftë të armatosur me çliruar Kosovën nga pushtimi i Serbisë dhe të tjerët deklarorin që duhet përgatitur populli dhe kur të krijohen kushtet, duhet edhe të luftohet, nëse duhet. Dhe, kështu duke kujtuar e debatuar me bacën në distancë me kishte zënë gjumi. Në mëngjes zgjohemi, pasi ra zilja. I kryejmë detyrat e mëngjesit, marrim mëngjesin dhe fillojmë leximin deri në kohën e shëtitjes. Lexojmë Frojdit dhe analizat e psikoanalizat e tij, nocione të ndryshme mbi shoqërinë, pjesë të cilave kishim mësuar edhe nëpër shkollë. Interesante ishin mendimet e Frojdit që shpjegonin zhvillimet e shoqërisë. Analiza interesante në shpjegimet e shoqërisë duke shpjeguar ëndrrat dhe dëshirat e individëve. Unin e tyre dhe shpërthimin e tyre në koncepte të ndryshme. Hapet dera dhe koha e shëtitjes, si dje dhe sot marrim topat dhe dalim për të luajtur me top që të marrim kondicion. Luajmë basket edhe pse unë nuk dija të luaja



sepe futbollin e luaja më mirë. Por për kohën e burgut të dyja ishin të mira për të ruajtur shëndetin e kondicionin fizik. Pas kryerjes se kohës se shëtitjes kthemi në dhomë. Fillon përsëri rutina. Por, sot kishim rendin e pastrimit në banjo. Larja e të burgosurve bëhej me dhoma, ku dhoma jonë e kishte radhën. Na kishin caktuar kohën dhe ne duhej të përgatiteshim. Dhe, në këtë kohë dimri ishte shumë ftohtë dhe terrohej shumë herët dhe kishte mjegull, ku dritat e shpërndanin më shumë atë. Ishte buzëmbremje, ku sa kishte filluar të errësohej dhe nuk dukej larg nga dritaret. Morëm peshqirët me vete dhe rrobat që kishim për t'i ndërruar. Shkuam grup dhoma jonë në banjo. Sapo hymë në banjo gardiani e lëshoi ujin e ne nen avullin e ujit të vakët dhe duke u fërkuar, gardiani bërtet nga jashtë: "Kurti dil jashtë". Albini del jashtë, gardiani foli më të në serbisht, pastaj hyri brenda në banjo dhe me afrohet i shqetësuar. Me thotë, aty në banjo, gardiani me tha, ka ardhur vendimi se më kanë liruar. Thotë duhet t'i bënte teshat gati dhe me dal. Thotë çfarë të bëjë? I them të lahem dhe dalim e bisedojmë në dhomë. Si me shpejtësi pastrohemi dhe vishemi e dalim nga banjoja e shkojmë në dhomë. Ishte i shqetësuar, kishte të drejtë dhe i them se çdo kundërshtim nuk ka efekt. Këtë e kisha nga përvoja nëpër burgje.

Por duhet ta menaxhojmë, të bisedojmë me drejtorin. Ju tregojmë edhe të tjerëve se ka një vendim me liruar Albinin sot. Së bashku me Isakun e Naimin, Vehbiun dhe të tjerë diskutojmë dhe nuk pajtohemi me liruar në këtë formë, pa pasur një garanci. Ne nuk pajtohemi me liruar në mbrëmje, pse në mbrëmje me u liruar kur ka mundësi ditën? Kush do ta merr nga burgu për ta dërguar në Kosovë. Ne nuk dinim a ka ardhur kush me marrë, ne ishim brenda mureve, ishte natë, ishte terr, asgjë nuk shihje jashtë, as nuk kishim njoftime nga Prishtina. Bisedonim dhe i them se në nuk të lejojmë me dalë pa pasur garanci. Dhe, kundërshtimi jonë duhet të merret si shqetësim për drejtorin e burgut. Sepse ne kishim përvojë të keqe në lirimet e tilla. Kishim përvojën e lirimet të profesor Ukshin Hotit nga burgu i Dubravës dhe askush me nuk dinte gjë për të se ku ndodhet. Në mbrëmje nuk ishte praktik lirim i askujt. Ditën liroheshin të burgosur. Por ne mund të rezistonim dhe duhej të rezistonim sepse kishim frikë nga më e keqja. Nga shteti serb pritej çdo gjë sepse për qëllime të veta nuk kursente asgjë dhe duhej pasur kujdes. Ne kundërshtuam gardianët. U bë situatë shumë e ndjeshme. Hymë në negociime me gardianët dhe mbikëqyrësin e burgut. Nuk e lëmë me dalë pa garanci, duam garanci se kush e merr dhe duam ta përcjellim deri të porta e të shohim se kush po e merr për ta dërguar në Kosovë. Ata thoshin Kryqi i Kuq. Ne nuk besonim në fjalët e tyre. Ata këmbëngulnin në të tyren, ne kundërshtonim. Ne u organizuam në mbrojtje dhe mosdorëzim pa shkuar edhe ne deri të Kryqi i Kuq. Në këto negociime nga mbikëqyrësi na u tha që dy veta mund të vijnë me të deri të porta, ku e merr Kryqi i Kuq, për të parë e hequr dyshimet tona. Unë dhe Isak Hoti së bashku me Albinin i cili i morri teshat u përshëndet me të

burgosurit dhe dolëm nga dera e hekurt e katit tonë dhe shkuam deri të porta bashkë dy gardianë dhe ne tre. Të porta e hapen derën, aty erdhën të Kryqit të Kuq, pra në dhomën e hyrjes. U siguroam që janë të Kryqit të Kuq. Pastaj ne u përshëndetëm me Albinin, i uruam shëndet dhe rrugë të mbarë. Ai kur u përshëndet me mua mbet si i mpirë nga dhimbja e ndarjes, dhe duke shikuar prapa nga ne duke shprehur dhembjen, mendonte se "unë po dalë, por juve ku po ju lë". Ne, pasi e morri Kryqi i Kuq Albinin, ia bëmë me dorë në shenjë përshëndetje përtej hekurave të portës. Mua dhe Isakun gardianët na kthyen në dhomë. Na kthyen me nervoz, na kthyen duke na mëshuar dhe grahur si kafshë. U vinte inat nga rezistenca jonë. Nga qëndrimi jonë që nuk e lamë vet Albinin me marrë e me bërë çka të duan ata me të. Ata na sillnin me shkopinj gome e me grushte, por të gjitha këto grushte e shkopinj gome ishin të përballueshëm e të durueshëm për ne, sepse ne u siguroam se shoku ynë i burgosur Albin Kurti ishte në dorë të Kryqit të Kuq. Koncepti i të burgosurve është solidariteti ndaj njëri-tjetrit. Ne këtë solidaritet për të mbrojtur një të burgosur e në këtë rast, rasti jonë për ta mbrojtur Albinin i tmerronte gardianët. Ne ishim të kënaqur që ia arritëm qëllimit, pasi Albini u lirua pas garancisë që morëm.

Pas daljes se Albinit dhe marrjes nga Kryqi i Kuq sikur u qetësuam, pavarësisht dhunës që ushtruan ndaj nesh gjatë rrugës për në dhomë. Sapo doli ai dhe e përcollëm deri tek dera, kur u kthyem bëmë thirrje me telefon që nga burgu është liruar Albini dhe e ka marrë Kryqi i Kuq. Tashmë dhe në Prishtinë e dinë që Albin Kurti është liruar nga burgjet serbe më 7 dhjetor 2001, në mbrëmje nga burgu i Nishit. Lirimi i Albinit sikur i qetësoi dhe ju dha vullnet të duronin e qëndronin se dikush atje në Kosovë po kujdeset për lirimin e të burgosurve nga burgjet e Serbisë. Ai që po kujdeset për lirimin tonë ishte populli, drejtuesit politikë të Qeverisë së Kosovës dhe familjet tona, por ishte dhe faktori ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Amerikën. Amerika ishte në negociata me Qeverinë e Serbisë për lirimin tonë. (Vijon)

*** Më 12 qershor 2021, Albin Kurti në Divjakë, ka folur në lidhje me këtë ngjarje të cilën e ka përshkruar Nait Hasani.**





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Italia kualifikohet në finale të 'Euro 2020'



Londër, 6 korrik - Italia është finalisti i parë i Kampionatit Evropian "Euro 2020", pasi në gjysmëfinale e mposhti Spanjën pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 4-2. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat 1-1. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll me rezultat 0-0. Pas një ore lojë, Federico Chiesa shënoi një gol të bukur për rezultatin 1-0, kurse për Spanjën dhjetë minuta para fundit të kohës së rregullt rezultatin e barazoi Alvaro Morata. Në dy vazhdimet nga pesëmbëdhjetë minuta, Spanja ishte skuadër me e

mirë por nuk arriti të gjejë golin fitores. Në penallti Italia ishte me e suksesshme duke fituar me rezultat 4-2, kurse penalltinë vendimtare që i siguroi italianëve plasmanin në finale e shënoi Jorginho. Dani Olmo dhe Alvaro Morata dështuan nga pika e bardhë për Spanjën, derisa për Italinë, Locatelli. Për Spanjën shënuan nga penalltitë Alcantara dhe Moreno, derisa për Italinë, Belotti, Bonucci, Jorginho dhe Bernandeschi. Finalisti i dytë vendoset të mërkurën në mbrëmje ku do të takohen Anglia dh Danimarka.

Anglia dhe Danimarka në kërkim të finales

LONDËR, 6 KORRIK - Sonte (e mërkurë) mësohet edhe finalisti i dytë në Kampionatin Evropian "Euro 2020". Nga ora 21:00 në "Wembley" takohen Anglia dhe befasia e këtij kompeticioni, Danimarka. Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, është i mendimit se kombëtarja që drejtohet prej tij ka një mundësi speciale për ta bërë kombin e lumtur nëse do të arrijë që të triumfojë ndaj Danimarkës. "Ndeshjet e Anglisë bashkojnë familjet dhe komunitetet. Mundësia që ke kur luan për Anglinë për lumturi dhe për të krijuar mbrëmje të shkëlqyera për tifozët tanë, për kombin tonë, është shumë e veçantë. Këto janë ndeshjet që mbahen mend për gjithë jetën, dhe ti ndien vlerësimin që njerëzit kanë për lojtarët dhe për futbollistët. Kjo është diçka për të cilën duhet të ndihen vërtet

krenarë. Nëse je trajner është paksa si të jesh një prind, lë pas momentet për veten pasi mendon se çfarë mund t'u transmetosh të tjerëve. Ne jemi përgatitur mirë për gjysmëfinale sesa në të kaluarën. Edhe pse kjo nuk përcakton fitoren apo humbjen në një ndeshje futbolli, ka shumë faktorë për të cilët ne jemi të ndërgjegjshëm dhe me të cilët jemi përballur për t'u përgatitur më mirë", ka thënë Southgate.

Për këtë ndeshje foli edhe trajneri Kasper Hjulmand, i cili bëri me dije se danezët nuk kanë frikë nga Anglia, ani pse kualifikimi për në finale është një mision shumë i vështirë. "Ne nuk kemi frikë nga Anglia, por mendoj se edhe ata nuk kanë frikë nga ne. Nuk mendoj se Anglia ka ndonjë pikë të dobët, por unë jam i bindur që



ndaj çdo rivali në këtë Evropian mund të gesh hapësira për ta pasuar topin, për të sulmuar

dhe për të shënuar. Megjithatë, Anglia është një skuadër e kompletuar dhe mendoj se

ndaj saj misioni ynë për t'u kualifikuar do të jetë shumë i vështirë", ka thënë Hjulmand.



Prishtina pësoi humbje nga Ferencvarosi

Prishtinë, 6 korrik - FC Prishtina ka pësuar humbje prej 3-0 nga kampioni i Hungarisë, FC Ferencvaros. Kampioni i Kosovës arriti që të ruhet shumë mirë për më shumë se 70 minuta lojë, ku ata ditën të mbrohen por edhe të sulmojnë kohë pas kohe. Pjesa e parë kaloi me dominim të Ferencvaros, të cilët edhe goditën shtyllën por nuk e gjetën rrjetën. Edhe Prishtina kishte rastet e veta, e më i miri ishte ai i

Otto John ku arriti që të jetë ballëpërballë me portierin e Ferencvarosit por nuk shënoi. Në pjesën e dytë Prishtina ishte shumë më e mirë dhe madje filloi që ta dominojë kampionin hungarez. Ata disa herë rrezikuan portën kundërshtarë por pas minutës së 70-të Prishtina do të binte shumë në lojë. Fillimisht do të shënonte Nguen që mori një top të mirë nga Civic kurse tre minuta më vonë do të

shënonte edhe Mmaee pasi mori një asistim nga Mak. Pas katër minutave do të shënohet edhe goli i tretë dhe atë do ta shënonte Blaziq, një gol që u pësua pas një ndërprerje. Ky është një rezultat komod për Ferencvaros të cilët pas një jave do të vijjnë dhe të luajnë në Prishtinë. Në anën tjetër kampionit të Kosovës i duhet të bëjë shumë që ta përmbys këtë rezultat, por do ta këtë shumë të vështirë.

Verstappen: Kjo makinë është me 'krahë'

Këtë sezon Max Verstappen ka korrur pesë fitore në Formula 1 me makinën Red Bull, 15 në total në karrierën e tij, duke u konfirmuar një talent në pistë. Piloti holandez ka 32 pikë

avantazh nga Lewis Hamiltoni me Mercedes. "Nuk prisja që në Austri të arrinim dy fitore kaq të lehta. Makina ka qenë e shpejtë pavarësisht prej gomave që montonim", ka thënë

Verstappen. "Jam argëtuar gjatë dy javëve që qëndruam në Austri dhe tani kam një avantazh të lehtë. Gjithsesi, çdo gjë është e hapur, pasi sezoni është shumë i gjatë. Na duhet të

vazhdojmë kështu në çdo garë. Për momentin gjërat janë mirë dhe jam i përqendruar te puna ime. Falënderoj skuadrën për makinën. Duket se është me 'krahë', ka shtuar Verstappen.



Kosova U20, e gatshme për garat në Shkup

PRISHTINË, 6 KORRIK - Vashat e Kosovës U20 po vazhdojnë përgatitjet, ku garat po afrohen, derisa lojtarët po japin maksimumin në stërvitje. Përzgjedhësi i Kosovës U20, Furkan Saglik, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Kur kemi filluar përgatitjet nuk kemi qenë të kompletuar, sepse Astera Tuhina luan në Spanjë, kurse Enisa Kamerolli dhe Agnesa Rrahmani ishin të angazhuar me ekipin e Kosovës A. Por, jemi duke u munduar të krijojmë atmosferë të mirë dhe lojtarët të jenë sa më të afërta me njëra-tjetrën", ka thënë Saglik për faqen zyrtare të FBK-së. Te Kosova U20 angazhohen lojtarë që luajnë jashtë Kosovës si Dea Pushkolli në ShBA, Astera Tuhina, në Spanjë dhe Tringa Ukaj, në Suedi. "Ato luajnë jashtë dhe mendja e tyre është e hapur. Kjo na ndihmon shumë, por ne jemi duke krijuar një ekip të veçantë, ku nuk ka dallim mes lojtareve vendore dhe atyre që luajnë jashtë Kosovës", ka shtuar përzgjedhësi i Kosovës U20. Kosova do të luajë në grup me Rumaninë, Sllovakinë,



Luksemburgun dhe Maqedoninë e Veriut. "Ne do të luajmë me lojtarë 17 dhe 18-vjeçarë në një garë me U20. Do të jetë e vështirë. Do të mundohemi t'i ndihmojmë lojtarët tona që të rriten dhe të jenë të gatshme për Kombëtaren A. Ky është synimi primar për ne", nënvizoi ish-trajneri i Bashkimit, duke shtuar: "Rumania dhe Sllovakia kanë ekipe të mira dhe programe për të ardhmen.

Maqedonia e Veriut është e afërt me ne. Sigurisht se ne do ta japim maksimumin në çdo ndeshje, por synimi është të fitojmë ndaj Maqedonisë Veriore", u shpreh Furkan Saglik. Kosova U20 (F) do të marrë pjesë në Grupin E të FIBA U20 Women's European Challengers që do të organizohet në Shkup prej 13 deri më 18 korrik 2021.

PSG-ja dhe City fillojnë garën për transferimin e Messit

BARCELONË, 6 KORRIK - Nga njëra anë dëshira për të rinovuar me Barcelonën, nga ana tjetër interesimi i klubeve më prestigjioze evropiane, të cilat qëndrojnë në dritare, duke pritur të dinë zhvillimet e negociatave. E ardhmja e Leo Messit është ende pezull. Kampioni argjentinas është ende zyrtarisht pa kontratë. Lidhja me Barcelonën përfundoi më 30 qershor. Një situatë që, sipas raporteve të "Mundo Deportivo", po i dërgon PSG-në dhe Manchester Cityn drejt një sulmi të ri për gjashtë herë fituesin e "Topit të Artë". PSG-ja nuk fshihet. Presidenti Nasser Al-Khelaifi tashmë kishte bërë deklaratë të rëndësishme muajt e fundit: "Unë kurrë nuk kam folur për negociatat në progres, por presidenti i Barcelonës e di që Messit do t'i skadojë kontrata dhe është i lirë të flasë me këdo. Ne të gjithë kemi të drejtë të negociojmë me të". Sipas



gazetës spanjolle, PSG-ja që në radhët e veta e ka Neymarin, një mik i madh i Messit, dhe futbollistët argjentinas Di Maria, Paredes dhe Icardi mund të ndikojnë në transferimin e "Pleshtit". Manchester City është gjithashtu shumë i

interesuar për këtë çështje. Britanikët mund të përfitojnë nga prania e trajnerit Pep Guardiola dhe do t'i plotësonin ambicien lojtarit për ta fituar Ligën e Kampionëve, një synim që Manchester City ia ka vendosur vetes për sezonin e ardhshëm.

SHKURT

Faruk Statovci, trajner i ri i KEK-ut

Faruk Statovci është emëruar trajner i ri i skuadrës së KEK-ut. Lajmin e ka komunikuar vetë skuadra nga Obiliqi, kurse ndihmës i Statovcit do të jetë Tahir Morina. "Drejtori sportiv, Enis Nasufi, prezanton shtabin teknik të FC KEK-ut në krye me trajnerin Faruk Statovci dhe Tahir Morina për sezonin e ri 2021/22. Na prift e mbara!", thuhet në njoftimin e KEK-ut. Statovci, i cili ishte një futbollist mjaft i dalluar, sezonin e fundit ishte trajner i skuadrës së Bashkimit nga Koretini.

Brazili siguron finalen e Kupës së Amerikës

Brazili është skuadra e parë që ka siguruar një vend për në finalen e Kupës së Amerikës. Pesë herë kampionët e Botës e mposhtën me rezultatin e ngushtë 1-0 Perunë falë një goli të Lucas Paqueta në pjesën e parë të ndeshjes. Në minutën e 35-të Neymar jep një asistim të shkëlqyer dhe mesfushori i Lyonit dërgon topin në rrjetë. Brazili tashmë pret në finale fituesin e çiftit Argentinë - Kolumbi.

Bale mbetet në Real

Gareth Bale nuk e ka në plan që të largohet nga Real Madridi në këtë verë. Anëtori uellsian po rikthehet te "Los Blancos" pas një huazimi që e kishte te Tottenham Hotspuri. Bale thuhet se ka zhvilluar një bisedë telefonike me Carlo Ancelottin, duke kërkuar konfirmimin nga italiani rreth të ardhmës së tij. Kështu, Bale do të qëndrojë deri në fund të edicionit 2021/2022 te Real Madridi. Kontrata e tij skadon në verën e vitit të ardhshëm dhe ai do të largohet i lirë, pasi Florentino Perez nuk e dëshiron më në klub. Uellsiani është aktualisht lojtari më i paguar në klub dhe paga e tij ka bërë që Real Madridi të kërkojë në vazhdimësi shitjen e tij, por Ancelotti i ka ofruar edhe një shans.

Guendouzi prezantohet te Marseille

Marseille ka konfirmuar nënshkrimin e Matteo Guendouzi nga Arsenalin në huazim me detyrim blerje në fund të sezonit. Guendouzi u bashkua me Arsenalin në verën e vitit 2018 dhe fillimisht bëri përshtypje nën trajnerin e atëhershëm Unai Emery. Ai vazhdoi të luante nën Mikel Arteta pasi ai mori detyrën, por më pas nuk u fut më deri në fund të sezonit 2019-20. Francezi u bashkua me Hertha Berlin në huazim sezonin e kaluar, duke bërë 24 paraqitje në kampionat dhe duke shënuar dy gola. Ai tani ka rënë dakord të largohet nga Arsenalin përsëri.

Podolski transferohet në Poloni

Lucas Podolski festoi 36-vjetorin e lindjes muajin e kaluar. Karriera është drejt fundit dhe sulmuesi i njohur ka vendosur të rikthehet në vendlindje. I lindur në Poloni, më pas kalimi në Gjermani

në moshë të vogël, vend ku filloi të luante futboll. Podolski zgjodhi ta përfaqësonte Gjermaninë dhe ka luajtur me të gjithë kombëtaret e moshave. Kulmi ishte viti 2014, kur

skuadra e drejtuar nga Joachim Low, pjesë e së cilës ishte edhe Poldi, "pushtoi botën" duke fituar Botërorin e Brazilit. Pas aventurës turke me Antalyaspor, lojtari ofensiv ka zgjedhur ta vijojë

karrierën në Poloni te Gornik Zabrze, ekip me të cilin ka firmosur për vitin e ardhshëm. "Legjenda vazhdon", lexohet në videon e prezantimit të Podolskit te Gornik. Kujtojmë që

kampioni i botës ka luajtur me skuadra si Bayern Munchen, Arsenal, Inter, Koln, Galatasaray, Vissel Kobe dhe Antalyaspor para se të vendoste të rikthehej në vendlindje.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 si dhe Ligjit nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, si edhe në bazë të nenit 23 dhe 26 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë: **05.07.2021**, mori vendim të **ri publikojë**:

KONKURSI PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës

1. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkencë juridike);
Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
Provimi i jurisprudencës;
Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës ka këto detyra dhe përgjegjësi:
Shërben si sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore e Komunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin e Ndërmarrjes "Termokos";
Të sigurojë përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, komiteteve të Bordit dhe aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bënë përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës;
Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe t'i shpërndajë ato tek drejtorët dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve;
Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe t'i regjistrojë ato në librin e protokollit;
Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të Korporatës duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve të Bordit dhe duhet të sigurojë, që ato përputhen me procedurat e Bordit.
Mirëmban regjistrin e të dhënave të ndërmarrjes;
Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë;
Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet me Ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes;
Kordinon me KE përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
Merret me çështjet tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.

3. Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

Formulari i aplikimit;
CV;
Letër motivimi;
Dëshmi mbi kualifikimin profesional;
Dëshmi mbi përvojën e punës dhe shkollimin;
Certifikatë që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre muaj);
Kopje e letërnjoftimit;
Deklarata nën betim;
Lista e dokumenteve të dorëzuara.

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre me dokumentet tjera relevante në arkivin e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, Rr. Luan Haradinaj p.n., Prishtinë, duke filluar nga data **07.07.2021 deri me datën 06.08.2021**, çdo ditë pune prej orës 8:30 – 15:30, të adresuara për: "Bordin e Drejtorëve" të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.

Formulari për aplikim, Lista e Dokumenteve të dorëzuara dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrë e Ndërmarrjes.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 06.07.2021 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-21-004

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave – Metalurgjia e Zinkut
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Periudha: 3(tre) vite me mundësi vazhdimi
Data e shpalljes: 06.07.2021
Sqarimi: deri me 22.07.2021
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 22.07.2021
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Siguria e Ofertës : Shuma e Sigurimit të Ofertës është 1,000.00 €, valide për periudhë prej se paku 90 dite kalendarike nga data e hapjes se ofertave.
Siguria e ekzekutimit: Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit 3 (tri) pagesa mujore nga vlera e përgjithshme e kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej 3 vite nga data e nënshkrimit te kontratës.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit: 23.07.2021 në 10:00
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		



Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

U skladu sa odredbama člana 21. Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, odnosno odredbama člana 13 Zakona br. 04 / L-111 kao i Zakon br. 05 / L-009 o javnim preduzećima, kao i na osnovu člana 23. i 26. Statuta, Odbor direktora NPL PALLATI I RINISË SH.A. u Prištini, na sastanku održanom: 05.07.2021, doneo novu odluku o objavljivanju:

KONKURS ZA PRAZNO radno mesto

Naziv radnog mesta: Generalni savetnik / korporativni sekretar

1. Kualifikacije i profesionalna priprema:

Da poseduje diplome Univerziteta - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili magistar prava);
Posjedovati najmanje pet (5) godina profesionalnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili zakona o kompanijama;
Da bi se ispunili uslovi kvalifikacije prema članu 17.1, kao i da bi se ispunili kriterijumi neovisnosti prema članu 17.2 tačka (d). (0.6). (K). (I) Zakona br. 03 / L087 iz javnih preduzeća i izmena LNP-a br. 04 / L-111 član 13;
Posjedovati računalne vještine;
Ispit iz pravne nauke, znanje engleskog jezika (poželjno);

2. Glavne dužnosti i odgovornosti: Generalni savetnik / sekretar korporacije ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Služi kao sekretar odbora direktora i centralna je tačka komunikacije sa opštinskom komisijom akcionara o radu preduzeća "Termokos"; Osigurati praćenje procedura od strane Odbora, što uključuje organizaciju sastanaka Odbora, odbora, odbora i dioničara, te u saradnji sa predsjednikom Odbora pripremiti i rasporediti dnevni red; Voditi zapisnike sa sastanaka i distribuirati ih direktorima i Opštinskom odboru dioničara; Vodite zapisnike sa svakog sastanka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihov predsjedavajući drugačije ne zahtijeva). i zabilježite ih u knjigu protokola; Djeluje kao agent preduzeća za primanje obavijesti, osigurava dobar protok informacija unutar odbora, njegovih odbora i između odbora i viših menadžera preduzeća; Savjeti i usluge korporativnog sekretara bit će dostupni svim direktorima odbora i osigurava da se oni pridržavaju procedura odbora. Vodi registar podataka preduzeća; Prati zakonske promjene povezane s preduzećem obavještaavanjem odbora i uprave kompanije o promjenama i priprema potrebne upute za upravljanje kompanijom; Daje sve arhive, publikacije i / ili otkrivanja relevantnim vlastima, kako to može zahtijevati Zakon o javnim preduzećima ili statut preduzeća; Koordinira sa EK pripremu pisama (dokumenata) za sastanke Odbora direktora; Po potrebi se bavi drugim pitanjima upravljanja preduzećima.

3. Informacije o konkursnoj proceduri Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sljedeća dokumenta:

obrazac prijave;
Motivaciono pismo;
Dokaz o profesionalnoj kvalifikaciji;
Dokazi o radnom iskustvu i školovanju;
Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od tri mjeseca);
Kopija lične karte; Izjava pod zakletvom;
Spisak dostavljenih dokumenata.

Zainteresovani svoje prijave sa ostalim relevantnim dokumentima mogu predati u arhivi NPL PALATI I RINISË SH.A. sa sedištem u Prištini, Rr. Luan Haradinaj p.n., Priština, počev od 07.07.2021 do 06.08.2021, svakog radnog dana od 8:30 - 15:30, adresirano na: "Odbor direktora" NPL PALLATI I RINISË SH.A. sa sedištem u Prištini.

Obrazac prijave, Spisak dostavljenih dokumenata i Izjava, mogu se preuzeti sa veb stranice NPL YOUTH PALACE JSC. sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se može dobiti u kancelarijama preduzeća.

"InstaBuilt" L.L.C, bënë shpallje për likuidimin e kapitalit në shumen prej 5.042,616.87 euro

"InstaBuilt" L.L.C me seli në Milloshevë, Obiliq, e regjistruar pranë Agjencionit Kosovar për Regjistrim të Bizneseve, me numër të regjistrimit të biznesit 811568502, bënë shpallje për likuidimin e kapitalit në shumen prej 5.042,616.87 euro, (shih të bashkangjitur certifikatën dhe informatat e biznesit).



Kapitali i përgjithshëm: 5,871,123.00

Kapitali i likuiduar: 5,042,616.87

Mbetje e kapitalit; 828,506.13



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe për parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

I. Kandidati për drejtor të Agjencisë duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 8, të Ligjit nr. 03/L- 159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, si vijon:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Të ketë së paku diplomë universiteti katërvjeçar ose master;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale;
- Të ketë integritet të lartë moral;
- Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit);
- Curriculum Vitae (CV – biografia personale);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

II. Kuvendi i Kosovës ofron mundësi të barabarta për punësim për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, gra dhe burra, të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen, jo më vonë se deri më 21.7.2021, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" p.n., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" p.n. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

"Ky proces rekrutimi do të monitorohet nga përfaqësues të Projektit Britanik për Emërime në Pozita të Larta. Kandidatët njoftohen, që rezultatet dhe emrat e kandidatëve me rangimin më të lartë, që mund të emërohen, do të publikohen në ueb faqen e projektit".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština republike Kosovo, ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor Direktora Agencije protiv korupcije

Agencija protiv korupcije je nezavisan i specijalizovan organ za primenu državnih politika u borbi i sprečavanju korupcije na Kosovo.

I. Kandidat za direktora Agencije treba da ispuni uslove predviđene Članom 8, Zakona br. 03/L- 159 o Agenciji protiv korupcije, kako slede:

- Da bude državljanin Republike Kosovo i da ima trajno prebivalište na Kosovo;
- Da ima najmanje četvorogodišnju univerzitetsku diplomu ili master;
- Da nije kažnjen za krivično delo;
- Da ima visoki moralni integritet;
- Da ima najmanje 5 (pet) godina stručnog radnog iskustva.

Aplikaciji se trebaju priložiti sledeći prateći dokumenti:

- Dokaz o stručnoj i obrazovnoj spremi (diplome univerziteta van zemlje, trebaju biti nostrifikovane od strane Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije);
- Curriculum Vitae (CV – lična biografija);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjen za krivično delo.

II. Skupština Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo, ženama i muškarcima, svih zajednica Kosova.

POSTUPCI KONKURISANJA

Aplikacije se trebaju dostaviti, ne kasnije od 21.7.2021. godine, do 16:00 časova.

Aplikacije se mogu lično dostaviti ili putem pošte na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ b.b, Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu preuzeti na ova mesta:

U štampanom formatu: pri recepciji Skupštine Republike Kosovo Priština, ul. „Majka Tereza“ b. b. ili

U elektronskom formatu: internet stranica Skupštine Republike Kosovo www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije se mogu primiti svakim radnim danom do 16:00 časova, na sledećim telefonskim brojevima: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikacije se trebaju dostaviti zajedno sa zahtevanim dokumentima. Upotreba pogrešne aplikacije i nedovršene sa zahtevanim podacima i sa nejasnim podacima i sa podacima koje su dostavljene nakon roka, smatraće se nevažećim.

"Ovaj postupak zapošljavanja nadgledaće predstavnici britanskog Projekta za imenovanje na visokim pozicijama. Kandidati se obaveštavaju da će rezultati i imena najviše rangiranih kandidata koji mogu biti nominirani biti objavljeni na veb stranici projekta."



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

